



Republika e Kosovës  
Komuna e Drenas(Gllogoc)  
Kuvendi i Komunës



Nr. 170/01-62185 dt. 28.12. 2023

Bazuar në nenin 11,12 paragrafi 40 Ligjit për Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, si dhe bazuar në nenin 3, pika 3.5 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, **27.12.2023**, miratoi këtë:

## VENDIM

### Për shpalljen e z. Rexhep Selimi, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

#### Neni 1

Ky Vendim miratohet nga Kuvendi i Komunës për shpalljen e z. Rexhep Selimi "Qytetar Nderi" i komunës së Drenasit.

#### Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Rexhep Selimi i jepet për kontributin e tij në çlirimin e vendit, shtet formimin dhe shtet ndërtimin e Kosovës si dhe për proceset historike që ka kaluar Kosova.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i komunës së Drenasit.

#### Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

#### Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:  
Zyrës së Kryetarit ;  
Drejtorisë Përkatëse;  
Zyrës së Kuvendit;  
Arkivit;  
Palës;



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

## ARSYETIM

### **Rexhep Selimi**

Veprimtar, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka lindur më 15 Mars 1971 në Aqarevë, Skenderaj.

Shkollimin fillor e kreu në Klinë, të mesmin në QAMO “Luigj Gurakuqi” në Klinë. Studimet universitare i kreu në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe.

Rexhep Selimi është themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Rexhep Selimi më 28 Nëntor 1997 ka bërë paraqitjen e parë publike të UÇK-së në Llaushë të Skenderajt. Në 1998 ka qenë drejtues i Drejtorisë së operacioneve në SHP të UÇK-së. Më pas, Selimi ka qenë Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së. Gjatë viteve 1999- 2000 ka qenë Ministër i Rendit Publik në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

Nga viti 2000 deri në 2003 Rexhep Selimi ka qenë Komandant i Akademisë së Mbrojtjes dhe Komandant i Komandës së Trajnimit dhe Doktrinës në TMK. Rexhep Selimi ka gradën gjeneral major.

Pas largimit nga AAK-ja, disa vite me vone pra në vitin 2010 i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje! dhe zgjidhet deputet i Lëvizjes. Ai gjatë mandatit 2011-2014 ka qenë anëtar i Komisionit parlamentar për Siguri, Punë të mbrendshme dhe mbikqyrje të FSK-së, ndërsa më 2019, Shef i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes!